



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Agjencia e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan** adresa: Lagjja "Shkumbini", Elbasan.

Drejtuar: **"HASTOÇI" Sh.p.k** me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Pjetër Bogdani, Pallati nr.17, Apartamenti 5/3, përballë Kopshtit nr.31, Tiranë.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-54906-12-23-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës "Marije Buda" dhe "Hamdi Roseni"**, me fond limit: **17,651,150** (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë) **lekë (pa tvsh) lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan, dhe me afat për kryerjen e punimeve **3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "HASTOÇI" Sh.p.k me Nipt: J62028009B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **17.388.551,25** (shtatëmbëdhjetëmilion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një presje njëzet e pesë) **lekë (pa tvsh)**.

2. “2 N” Sh.p.k me Nipt: L31615017L

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **14,894,035** (katërmëdhjetëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e pesë) **lekë (pa tvsh)**.

3. “Shendelli” Sh.p.k me Nipt: K07924803N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **14,873,523** (katërmëdhjetëmilion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tre) **lekë (pa tvsh)**.

4. “DENIS-05” Sh.p.k me Nipt: K51518029B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **16,627,989** (gjashtëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) **lekë (pa tvsh)**.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. “2 N” sh.p.k me Nipt: L31615017L përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

Autoriteti kontraktor në mbështetje të nenit 82, pika 2 të LPP i kërkoi ofertuesit 2 N shpk sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, për arsye se ishte e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës. Konkretisht AK gjatë verifikimit të dokumentacionit të paraqitur konstatoi se ofertuesi 2 N shpk ka paraqitur formularin përmbledhës të deklaramentit (shtojca 8) ku në seksionin C-Deklaratë, tek kontratat e furnizimit, të cilat duhet të jenë noteriale, ka deklaruar se ka lidhur kontratë furnizimi noteriale me nr.prot. 866 datë 11.01.2023 për furnizimin me elementë betoni, bordura dhe pllaka. Duke qenë se kontratat noteriale regjistrohen me nr.rep dhe kol., ofertuesit 2 N shpk iu kërkua të na sqaronte në lidhje me këtë dy kontrata të regjistruar me nr. prot. 866 datë 11.01.2023, si dhe të paraqiste si dokumentacion mbështetës edhe një kopje të kësaj kontrate.

Ofertuesi 2 N shpk nuk paraqiti asnjë sqarim si dhe dokumentacion mbështetës brenda afatit të përcaktuar nga AK.

Oferta juaj s’kualifikohet për arsyen e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 76 pika 3 gërma ë), ndër të tjera parashikohet se autoriteti kontraktor skualifikon çdo operator, i cili nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. “DENIS-05” Sh.p.k me Nipt: K51518029B përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

Nuk keni deklaruar në shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë se keni të punësuar si staf teknik, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim minimalisht punonjësit e mëposhtëm:

- 2 (dy) Karpentier

Oferta juaj s’kualifikohet për arsyet e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

3. “Shendelli” Sh.p.k me Nipt: K07924803N përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

Operatori ekonomik “**Shendelli**” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kërkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Oferta juaj s’kualifikohet per arsyen e mësipërme.

Në nenin 76 pika 3 gërma ë) e Ligjit nr.162 date 23.12.2020 ndër të tjera thuhet se autoriteti kontraktor skualifikon çdo operator, i cili nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“HASTOÇI” Sh.p.k me Nipt: J62028009B** me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Pjetër Bogdani, Pallati nr.17, Apartamenti 5/3, përballë Kopshtit nr.31, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **17.388.551,25** (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një presje njëzet e pesë) **lekë (pa tvsh)** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Drejtori i Përgjithshëm i ASHP
Edvin Palloshi